



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:047521

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06012482

PA1.nr. 584/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Skender Çoçaj kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantes- procesmbajtëse Fitore Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.U nga Lipjani, për shkak të veprës penale “vjedhje” nga neni 313 par. 1 të KPRK -së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit D.U av.V.B nga Lipjani, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.55/24 të dt. 29.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.U av. V.B nga Lipjani.

II. NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.55/2024, të datës 29.02.2024, sa i përket përllogaritjes së kohës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar, ashtu që Kolegji Penal i kësaj Gjykate duke e vërtetuar dënimin unik me gjobë të shqiptuar ndaj të akuzuarit D.U nga Gjykata e shkallës së parë, në shumën prej 1200 euro i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, por që të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim nga data 10.02.2024 e deri më dt. 10.03.2024 do t'i llogaritet në dënimin me gjobë të shqiptuar.

III. Në pjesë të tjera, aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin D.U e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale të “vedhjes” nga neni 313 par. 1 të KPRK -së, dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim unik me gjobë në shumën prej 1200 euro të cilën denim është i obligura ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e cekur, e njëjta gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim, duke ja llogaritur për nga 20 euro një ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Palët e dëmtuara: I.B për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo-juridik.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të akuzuarit av. V.B për shkak të shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit mbi dënimin, duke i propozuar kolegjit penal të gjykatës së Apelit t’a ndryshoj aktgjykimin sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që të akuzuarit t’i shqiptohet një dënim më i butë, dhe t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, ose që të njëjti t’a anulohet dhe çështjen t’a kthejë në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II nr.587/24, të datës 17.04.2024, ka propozuar që pjesërisht të aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit me propozim që të anulohet aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të akuzuarit dhe gjeti se

- ankesa pjesërisht është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimin nuk është goditur me ankesë, për shkak të shkeljeve të esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPK-së, e sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimin i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimin i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPK-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përkthyer qartë të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari.

Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penal.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, edhe pse me ankesë është atakuar, ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas konsultimit me mbrojtësin. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Aktgjykimi i ankimuar është goditur për shkak të shkeljes të Ligjit Penal, kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe për shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar pjesërisht është i përfshirë me shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit pasi që në dënimin me gjobë të shqiptuar nuk është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim për të akuzuarin, ndërsa aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit në pjesë tjera të aktgjykimit për faktin se kualifikimi i veprës penale është i drejte dhe se janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale dhe se nuk ekziston ndonjë rrethane që e përjashton përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë ka theksuar se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese duke pasur parasysh faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, është penduar, premtimin se nuk do të kryej vepra tjera penale, moshë e re e të akuzuarit, pala e dëmtuar V.K është tërhequr nga ndjekja penale dhe është tërhequr edhe nga kërkesa pasurore juridike, dhe ka kërkuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë më i ulët.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, që të njëjtit t'i shqiptohet dënim me gjobë më i butë janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se kolegji penal i kësaj Gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën nga mbrojtësi i të akuzuarit janë të bazuara sa i përket mos llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim të akuzuarit në dënimin me gjobë të shqiptuar ashtu siç është përcaktuar në nenin 83 par. 1 të KPRK –së, se: **“koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë”** andaj mbi këtë bazë Gjykata e Apelit e ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim të akuzuarit në dënimin me gjobë të shqiptuar, ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.584/24, me datë 23.07.2024

Praktikantja- procesmbajtësja,
Fitore Zeka

Kryetar i kolegjit,
Skender Çoçaj

Anëtarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Zyhdi Haziri